

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE
“3 & MORE” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 05/10/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), të nënshkruarit:

- **Z. Zamir Collaku**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20.07.1966, lindur në Tiranë dbe banues në Tiranë, Shqipëri, person madbor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit nr.033570515.
- **Z. Erjon Rama**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.03.1986, lindur në Tiranë dbe banues në Tiranë, Shqipëri, person madbor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit nr.025333806.
- **Z. Elton Memeti**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17.07.1984, lindur në Tepelenë dbe banues në Tiranë, Shqipëri, person madbor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit nr.028551321.

Vendosën:

Themelimin e shoqërisë tregtare “3 & more” Sh.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare Ecoalmax SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “3 & more” SH.P.K

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar te lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrrja ne çdo veprimitari apo aktivitet te ligjshëm qe mund te kryeje një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here dhe ne veçanti, por pa u kufizuar në;

Shoqëria do te kryeje veprimitari tregtare per aktivitet bar, kafë, restoran, catering, per kete do te angazhohet ne: Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice; import-eksport te mallrave ushqimore, piye si alkoolike dhe jo alkoolike. Tregtimin me shumice dhe pakice dhe import-

eksport, te pajisjeve te kuzhines, te mobilimit te nevojshme per aktivitetin bar, kafe, restoran, catering. Konsulencë Organizim eventesh cattering. Hapje mbyllje lokalesh. Investime në turizëm, hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, bar-kafe, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi dhe kurative në fushën e turizmit në përgjithësi

Shoqeria do te bashkepunoje me persona te tjere fizike ose juridike qe ushtrojne te njejten veprimtari ne Shqiperi ose jashte saj.

Gjithashtu, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter qe lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, çdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, si dhe çdo veprimtari me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që mund te konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

Për ushtrim të aktivitetit të shoqërisë me gjithë ndryshimet që mund të ketë shoqëria mund të hyjë më marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me palë të tretë qofshin ente publike apo private, të marrë pjesë në procedura të ndryshme konkurrimi në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkuesave të ligjit të fushës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranë s, në adresën: Rr: Ibrahim Rrugova, ndërtesa 28, hyrja 9, Capriccio bar Tiranë.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para, në vlerën prej 100 (njëqind) lek, të ndarë në 3 kuota të zotëruara si më poshtë vijon:

- **Z. Zamir Çollaku**, zoteron një kuotë me vlerë 60(Gjashtëdhjetë) lek që përfaqëson masën prej 60% të kapitalit të shoqërisë;
- **Z. Erjon Rama**, zoteron një kuotë me vlerë 30 (tridhjetë) lek që përfaqëson masën prej 30% të kapitalit të shoqërisë; .
- **Z. Elton Memeti**, zoteron një kuotë me vlerë 10 (dhjet) lek që përfaqëson masën prej 10% të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali themeltar përbëhet tërësisht nga kontributete e ortakëve themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortak themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ta.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve/ortakut të vetëm.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/orataku i vetëm – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat nje vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë **Erjon Rama**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05..03.1986, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit nr.025333806.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKET THEMELUES

Zamir Collaku

Zamir Collaku

JC

Erjon Rama

ERJON RAMA

Elton Memeti

Elton Memeti